



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 15.03.2023

Nr: 26

Ora: 15:45

VENDIM I NDËRMJETËM

**PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 32, DATË
14.03.2023 DHE NR. 33, DATË 15.03.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesës ankimore nr. 32, datë 14.03.2023 dhe nr. 33, datë 15.03.2023

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 32 regj., datë 14.03.2023. Në mbledhjen e datës 15.03.2023, ora 14:30, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 31 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 33 regj., datë 15.03.2023. Në mbledhjen e datës 15.03.2023, ora 15:30, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 33 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 15.03.2023, me vendimet nr. 24 dhe nr. 25, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Ledio Braho konstatuan se të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt.

Për sa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 32, datë 14.03.2023 dhe nr. 33, datë 15.03.2023. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 32, datë 14.03.2023 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 33, datë 15.03.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Koli Bele.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 32, datë 14.03.2023 dhe nr. 33, datë 15.03.2023;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 16.03.2023 ora 12:00 me relator z. Koli Bele;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Ky vendimi është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**